



Prishtinë, 10 janar 2012

Nga: **Dr. Ali Hamiti**, Kryesues i Bordit të ZRrE-së

Për: **Z. Arben Gjukaj**, Drejtor Menaxhues, KEK sh.a

Z. Fadil Ismaili, Drejtor Menaxhues, KOSTT Sh.a

Kopje: **Z. Besim Beqaj**, Ministër për Zhvillim Ekonomik

Z. Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit të Kosovës

Z. Zenun Pajaziti, Kryetar i Komsionit për Zhvillim Ekonomik, Tegtj dhe Industri

Z. Petrit Pepaj, Drejtor për Tarifa dhe Çështje Rregullative, KEK sh.a

Znj. Resmije Ahma, Drejtoreshë për Çështje Ligjore dhe Rregullative, KOSTT Sh.a

Lënda: Shqyrtimi i gjashtë i tarifave të energjisë elektrike (SHTE6)

Të nderuar

Po ju shkruajmë për t'ju bërë me dije për planet e ZRRE-së përkitazi me Shqyrtimin e 6-të të tarifave të energjisë elektrike (SHTE6), të cilat pritet të hyjnë në fuqi më 1 prill 2012.

Ky do të jetë shqyrtimi i parë i cili do të kryhet në kuadër të Rregullave të Reja të vendosjes së çmimeve, të lëshuara nga ZRRE. Sipas këtyre rregullave, rishqyrtimi i parë periodik i të hyrave të lejuara për bartësit e licencave OST/OT dhe OSSH do të bëhet sipas dispozitave kalimtare, ku të hyrat, tarifat dhe ngarkesat e lejuara, do të vlejnjë për një periudhë prej një viti (gjegjesisht, deri më 31 mars 2013). Pas kësaj, do të bëhet shqyrtimi i plotë periodik i cili do të shpjerë në përcaktimin e të hyrave të lejuara për një periudhë shumëvjeçare, e cila do të fillojë nga 1 prilli 2013. Të hyrat e lejuara për Furnizuesin Publik të Energjisë elektrike (FPPE) do të përcaktohen mbi bazat e kostos së bartur të blerjes së energjisë dhe të ngarkesave për rrjet, krahas përcaktimit edhe të vlerave të tjera¹ në kuadër të dispozitave kalimtare. Dispozitat kalimtare mundësojnë një proces shqyrtimi shumë më të shkurtër nga ato që zakonisht zbatohen për shqyrtimet periodike.

¹ Këto vlera janë të definuara në Nenin 7 të Rregullit mbi *Përcaktimin e çmimeve për furnizues publik të energjisë elektrike* dhe përfshijnë jetëgjatësinë e lejuar të aseteve, margjinën e shitjes me pakicë, ndihmën për borxhet e këqija dhe faktorin e ndarjes së eksportit.



Rregullat e reja të përcaktimit të çmimeve nuk ofrojnë ndonjë mënyrë kalimtare të shqyrtimit për Gjenerimin². Mirëpo, ZRRE konsideron se nuk është e mundur që të bëhet rishqyrtimi i plotë periodik për të gjithë të licencuar, pasi që, sipas Rregullave të përcaktimit të çmimeve, shqyrtimi i tillë duhet të iniciohet të paktën 120 ditë pune para hyrjes në fuqi të të hyrave të reja të lejuara. Prandaj, ZRRE propozon kryerjen e shqyrtimit kalimtar për këta të licencuar sipas procedurave të njëjta si për të licencuarit e tjerë³.

Orari për shqyrtimin i cili do të kryhet në kuadër të dispozitave kalimtare, ashtu siç përcaktohet në Rregullat për përcaktimin e çmimeve, është si në vijim:

- Inicimi i shqyrtimit: 60 ditë para fillimit të periudhës rregullative.
- Vlerësimi kalimtar i propozimeve të të licencuarve nga ZRRE publikohet për konsultim publik: 45 ditë para fillimit të periudhës rregullative:.
- Vendimi përfundimtar nga ZRRE mbi të hyrat e lejuara për periudhën rregullative: 30 ditë para fillimit të periudhës rregullative

Në përputhje me këto dispozita, ZRRE për SHTE6 propozon miratimin e orarit vijues:

- Inicimi i SHTE6. ZRRE do të shpall njoftimin publik lidhur me këtë dhe do të kërkojë parashtrimin e propozimeve mbi të hyrat e lejuara nga të licencuarit (me përjashtim të FPEE, të cilit do t'i kërkohet të parashtrijë propozime për vlerat hyrëse): **10 janar 2012**
- Parashtrimi i të hyrat e lejuara të propozuara nga të licencuarit: **16 janar 2012.**
- Publikimi i vlerësimit kalimtar të propozimeve të të licencuarve nga ZRRE për konsultim publik: **30 janar 2012**
- Data e mbylljes së konsultimit publik: **13 shkurt 2012.**
- Vendimi përfundimtar nga ZRRE mbi të hyrat e lejuara për të licencuarit: 20 shkurt 2012.
- Dorëzimi nga të licencuarit i propozimeve për tarifa dhe ngarkesa të rregulluara, në përputhje me të hyrat e lejuara të aprovuara si dhe me metodologjitë e ngarkesave: **1 mars 2012.**
- Vendimi përfundimtar nga ZRRE për tarifa dhe ngarkesa të rregulluara: **deri më 15 mars 2012.**

² Prodhuesi i cili sipas Ligjit mbi energjinë elektrike është i obliguar të furnizojë FPEE me çmimin e rregulluar në rastet kur nuk ekziston konkurrencë e mjaftueshme e shitjes me shumicë, ndërsa FPEE i nevojitet furnizimi për të përmbushur obligimin e vet.

³ Të definuar si të licencuarit e tjerë, tarifat apo ngarkesat e të cilëve janë të rregulluara pjesërisht apo tërësisht nga ZRRE. Këtu përfshihen prodhuesit e rregulluar, OST/OT, OSSH dhe FPEE.



Udhëzime mbi aplikacionet

Do të dëshironim gjithashtu që ta shfrytëzojmë këtë mundësi që të ju ofrojmë disa udhëzime mbi disa aspekte specifike të aplikacionit për tarifë:

- Aplikacioni duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Rregullave për përcaktimin e çmimeve të lëshuara nga ZRRE.
- Sipas kritereve të lëshuara nga ZRRE, konkurrenca efektive në shitje me pakicë ende nuk ekziston për asnjë kategori të konsumatorëve. Prandaj, duhet të supozohet se të gjitha kategoritë e konsumatorëve do të furnizohen me çmime të rregulluara, për qëllime të këtij rishqyrtimi.
- Bilanci i energjisë i dërguar si pjesë e aplikacionit për tarifë, duhet të jetë në përputhje me atë të miratuar nga MZHE për vitin e ardhshëm. Çfarëdo devijimi nga ky bilanc i aprovuar duhet të arsyetohet në tërësi nga të licencuarit.
- Supozimet mbi subvencionet operative (importi) duhet të jenë konsistente me ato në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës (BKK) të fundit të aprovuar. Dallimet ndërmjet subvencioneve operative të supozuara dhe atyre realisht të pranuar në vitin paraprak, duhet të përfshihen në të hyrat të cilat propozohen të sigurohen me tarifat e rregulluara.
- Për shkak të transparencës, ZRRE propozon të publikojë në tërësi aplikacionet për tarifa nga të licencuarit, krahas vlerësimeve të tyre. Prandaj, të licencuarit duhet të identifikojnë ndonjë pjesë të cilën e konsiderojnë si konfidenciale.

Luteni që të na kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje lidhur me këtë shkresë.

Me respekt,

Dr. Ali Hamiti

Kryesues i Bordit të ZRRE-së